


**DOKUMENTI
I PLANIFIKIMIT INDIVIDUAL
TE AKTIVITETEVE
TE EDUKIMIT TE VAZHDUAR
PER PROFESIONISTET
E SHENDETESISE**



qkev

QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM



QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM

DOKUMENTI
I PLANIFIKIMIT INDIVIDUAL
TE AKTIVITETEVE
TE EDUKIMIT TE VAZHDUAR
PER PROFESIONISTET
E SHENDETESISE

Ilir Shamata

© Të drejtat e këtij botimi i përkasin QKEV

Për më shumë informacion kontaktoni:

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim

Rr. Aleksandër Moisiu, Nr.84, Tiranë, Shqipëri.

Tel: +355 4 2452286

E-mail: info@qkev.gov.al

www.qkev.gov.al

Ky botim është mbështetur nga projekti “Sistemi për Zhvillim Profesional” me fondet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim



Përmbajtja:

1.	Qëllimi dhe objektivat e dokumentit	6
2.	Paraqitje e shkurtër e procesit të ricertifikimit	12
3.	Planet e edukimit: Si të krijoni një të tillë?	19
4.	Të mësuarit gjatë gjithë jetës. Si mund ta bëni atë pjesë të jetës suaj?	35
5.	Përmirësimi i cilësisë së praktikës profesionale.	39

1. Qëllimi i dokumentit

Ky dokument ka si qëllim të ndihmoje profesionistët e shëndetësisë ne procesin e planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional të tyre.

Ky dokument është hartuar për: mjekët e përgjithshëm dhe specialistë të tre niveleve të ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor; për stomatologët dhe farmacistët që punojnë si në sistemin publik të shërbimeve shëndetësore ashtu dhe në atë privat.

Edukimi ne vazhdim i profesionistëve të shëndetësisë është një proces që ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë. Kjo si pasojë e nevojës së natyrshme të profesionistëve të shëndetësisë për të ngritur nivelin e njohurive dhe aftësive të tyre në përmbushje të misionit të tyre të kujdesit për shëndetin e pacientëve dhe të publikut në tërësi.

Kërkesa për ta përmirësuar, rregulluar dhe institucionalizuar këtë proces sa të natyrshëm aq dhe të domosdoshëm për profesionistët e shëndetësisë është reflektuar në ngritjen e QKEV-së nga Ministria e Shëndetësisë për të asistuar profesionistët e sistemit shëndetësor në këtë proces.

Nëpërmjet një kuadri rregullator të miratuar së fundi nga Ministria e Shëndetësisë, profesionistët e shëndetësisë kanë mundësinë dhe njëkohësisht detyrimin të bëhen pjesë e një procesi të ricertifikimit të njohurive dhe aftësive të tyre profesionale.

Zbatimi i një kuadri të ri rregullator shoqërohet me sfida si për profesionistët e shëndetësisë që janë subjekt i tij, ashtu dhe për institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe ato të ofrimit të edukimit në vazhdim.

Për të asistuar profesionistët e shëndetësisë në përballjen me zbatimin e këtyre kërkesave të reja ky dokument është hartuar për të paraqitur në mënyrë të strukturuar procesin e planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit të vazhduar mjekësor dhe zhvillimit profesional për profesionistët e shëndetësisë që janë subjekt i programit të ricertifikimit.

1.2 Objektivat e dokumentit

Ky dokument synon të realizojë objektivat e mëposhtme:

1. *Të rrisë njohuritë e profesionisteve të shëndetësisë lidhur me rolin që QKEV-ja luan në ndihmë të planifikimit individual të aktiviteteve të*

edukimit të vazhduar dhe zhvillimit profesional për profesionistët e shëndetësisë.

- 2. Të udhëzojë profesionistët e shëndetësisë për procesin e vlerësimit individual të nevojave për edukim të vazhduar, si dhe hartimit të planit individual të veprimeve për edukim të vazhduar dhe zhvillim profesional.*
- 3. Të ndihmojë profesionistët e shëndetësisë në kuptimin dhe zbatimin praktik të planit individual për edukimin në vazhdim, duke përmbushur detyrimet profesionale, normative dhe institucionale që dalin para tyre në funksion të ushtrimit sa më profesional dhe të rregulluar të profesionit.*

1.3 Çfarë mund të bëjë QKEV-ja për ju?

1.3.1 Çfarë do të thotë ricertifikimi për ju?

Gjithmonë e më tepër, publiku, pacientët, agjencitë rregullatore dhe institucionet shëndetësore po kërkojnë nga profesionistët e shëndetësisë që të demonstrojnë një nivel të lartë njohurish profesionale dhe të ofrojnë kujdes shëndetësor të një cilësie të lartë.

Programi i ricertifikimit ju ofron mundësinë të demonstroi aftësite tuaja për të ofruar kujdes shëndetësor të sigurtë dhe efektiv si dhe dedikimin tuaj për të mësuar dhe për të vlerësuar performancën tuaj përgjatë gjithë jetës.

Ricertifikimi është një mënyrë e mirë nëpërmjet të cilës ju mund tu tregoni pacientëve dhe kolegeve tuaj që ju mbështesni këtë përpjekje të organizuar për të përmirësuar praktikën tuaj mjekësore dhe gjithashtu që ju jeni i gatshëm të përmirësoni performancën përgjatë gjithë karrierës suaj.

Pjesëmarrja në këtë proces të ricertifikimit demonstroi jo vetëm që ju keni njohuritë e duhura për të ushtruar profesionin në praktikat tuaja mjekësore në institucione publike apo private, por gjithashtu demonstroi që ju përpigëni vazhdimisht të mbani një nivel bashkëkohor të njohurive tuaja dhe përmirësoni në mënyrë të vazhdueshme shërbimin shëndetësor që ju ofroni, në dobi të pacientëve tuaj.

1.3.2 Si mund t'ju ndihmojë QKEV-ja?

Për të ndihmuar mjekët, stomatologet dhe farmacistet, që punojnë në sistemin shëndetësor shqiptar, të plotësojnë kërkesat e programit të ricertifikimit, QKEV-ja ofron mundësitë e mëposhtme:

- *Plani i veprimit për edukim mjekësor në vazhdim* - Në faqen e saj në internet ëëë. qkev.gov.al, QKEV-ja paraqet formate të cilat mund të përdoren nga ju për të zhvilluar një plan individual të aktiviteteve të edukimit të vazhduar mjekësor dhe zhvillimit profesional si pjesë e kërkesave të procesit të ricertifikimit. Ndërkohë që plotësoni planin, ju *listoni* kërkesat për edukim të vazhduar që dalin para jush, *prioritizoni* nevojat tuaja për të mësuar, *planifikoni* aktivitete të EV në të ardhmen dhe *ruani* informacionin rreth aktiviteteve të edukimit të vazhduar ku planifikoni të merrni pjesë në funksion të procesit të mësuarit përgjatë gjithë jetës.
- *Konferencat Vjetore Kombëtare të QKEV-së*— Konferencat vjetore kombëtare të QKEV-së do të jenë një burim i pasur me informacion për studime lidhur me nevojat për trajnim të analizuar për grupe dhe kategori të ndryshme të profesionistëve të shëndetësisë, për kurse dhe trajnime të organizuara nga ofrues të ndryshëm të edukimit mjekësor të vazhduar, nga shoqatat profesionale dhe institucionet shëndetësore, paraqitje të botimeve të reja shkencore dhe promovimit të revistave dhe botimeve të tjera mjekësore.

- *Ndërveprimi në internet*—Në faqen në internet të QKEV-së do të gjeni informacion mbi studime të vlerësimit të nevojave për trajnim të profesionistëve të shëndetësive të kryera nga QKEV, planet e aktiviteteve trajnuese të ofruesve të ndryshëm të programeve të edukimit në vazhdim, si shoqatat profesionale, institucionet e sistemit arsimor, OJF dhe organizma të tjerë publike dhe private që promovojnë rritjen e njohurive dhe aftësive të profesionistëve të shëndetësisë, ku ju mund të merrni pjesë dhe në të ardhmen dhe module trajnuese për grupe dhe kategori të ndryshme të profesionistëve të shëndetësisë.
- *Formularët e vetë-vlerësimit* – Formularët e vetë-vlerësimit të përgatitur nga QKEV-ja janë formularë të përgjithshëm që mund përshtaten me një numër të gjerë fushash të veçanta të specialiteteve të shëndetësisë për të bërë të mundur vete-vlerësimin e profesionistit për atë fushë specifike.

Plotësimi dhe paraqitja pranë QKEV-së i formularit të vete-vlerësimit nga profesionistët e shëndetësisë që janë subjekt i programit të ricertifikimit do të vlerësohet nga QKEV-ja me dy kredite.

2. Paraqitje e shkurtër e **procesit të ricertifikimit**

Programi i ricertifikimit do të organizohet në cikle 5-vjeçare. Cikli i parë fillon në Janar 2010 dhe përfundon në Dhjetor 2014. Kërkesat e ciklit të parë të programit të ricertifikimit janë të reduktuara në krahasim me ato të cikleve që vijojnë, për shkak të sfidave që lidhen me vënien në jetë të këtij programi në shkallë kombëtare.

Në ciklin e parë të programit të ricertifikimit, profesionistët e përfshirë në këtë program duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 150 kredite në 5 vjet. Në ciklet që vijojnë, numri i krediteve të detyrueshme për tu mbledhur brenda ciklit pesëvjeçar do të jetë 250.

Kriteret e programit të ricertifikimit

Numri i krediteve të rekomanduara dhe të detyrueshme në secilin vit kalendarik të ciklit të parë është i ndryshëm (viti i parë – 10 kredite; viti i dytë – 20 kredite; viti i tretë – 30 kredite; viti i katërt 40 kredite; viti i pestë – 50 kredite)

Në varësi të planeve të tyre individuale, profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit duhet të mbledhin të paktën 50% të krediteve të rekomanduara për

secilin vit kalendarik, me kusht që të plotësohet numri i përgjithshëm prej 150 kreditesh brenda ciklit të parë 5-vjeçar të programit.

Në rastet kur profesionisti nuk plotëson numrin e krediteve për secilin vit kalendarik, ose numrin e përgjithshëm prej 150 kreditesh në 5 vjet, atëherë vlerësohet se profesionisti nuk ka përmbushur kërkesat e programit të ricertifikimit bazuar në ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim dhe duhet t'i nënshtrohet sanksioneve të parashikuara në dokumentin e ricertifikimit.

Në ciklin e dytë dhe në ciklet e tjera të programit të ricertifikimit numri total i krediteve të kërkuara është 250 kredite në fund të ciklit pesëvjeçar. Numri i krediteve të rekomanduara është 50 kredite në vit dhe numri minimal i detyrueshëm është 30 kredite në vit. Profesionistët janë të lirë të transferojnë kredite nga njëri vit kalendarik në tjetrin të secilit cikël, me kusht që të plotësojnë numrin minimal të detyrueshëm të tyre për secilin vit dhe numrin total 250 kredite në 5 vjet.

Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht janë:

Trajnimi është një aktivitet në grup (20-25 vetë) ose individual, i orientuar kryesisht drejt praktikës

profesionale, që gërsheton dhënien e leksioneve me metoda të tjera pedagogjike. Qëllimi është që pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri, aftësi, shprehje ose kompetenca që iu nevojiten për të kryer në mënyrë të kënaqshme detyrat dhe punën e tyre aktuale. Trajnimi mund të jetë 1 deri 3 ditor, 1 javor ose disa javor, me seanca të njëpasnjëshme ose me ndërprerje mes tyre.

Konferenca është një aktivitet 1-2 ditor që mbahet mbi një temë të caktuar, zakonisht e ofruar nga shoqata profesionistësh, ku ekspertë të fushës prezantojnë disa leksione ose studime të reja. Organizohet në seanca plenare dhe/ose seanca paralele apo uorkshope. Qëllimi i konferencës është të informojë audiencën profesionale mbi të rejat e shkencës dhe teknologjisë në lidhje me profesionin në fjalë.

Seminari është një aktivitet mbi një çështje të caktuar profesionale, me një grup të vogël pjesëmarrësish (10-15), të cilët mësojnë duke marrë pjesë aktivisht. Gjatë seminarit diskutohen artikuj të caktuar, prezantohen studime të ndryshme, bëhen pyetje dhe debate në mënyrë jo formale.

Uorkshop-i është një aktivitet i një grupi të vogël me orientim drejt zgjidhjes së problemeve ku

pjesëmarrësit përfshihen aktivisht në diskutime ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi të ndihmuar nga eksperti/trajneri. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë duke provuar, gabuar dhe korigjuar vetë ose me ndihmën e të tjerëve.

Fokus-grup nënkupton një bashkëbisedim mes një grupi prej 6-15 profesionistësh, të drejtuar dhe moderuar nga një moderator, mbi një temë që përbën interes për të gjithë pjesëmarrësit.

Aktivitetet e edukimit në distancë janë aktivitete që ofrohen për studentët të cilët duan të mësojnë pa qenë të pranishëm fizikisht dhe në kohë reale. Në varësi të teknologjisë së përdorur aktiviteti mund të jetë sinkron ose jo sinkron. Në llojin e parë të gjithë pjesëmarrësit hyjnë në komunikim në të njëjtën kohë përmes telefonit, video-konferencës ose ueb-konferencës. Në llojin e dytë studentët përdorin materialet e shkruara, videokaseta, audiokaseta, e-mailin në kohën që ata dëshirojnë.

Programe universitare ose pasuniversitare (p.sh. kurs kualifikimi) janë programe të ofruara nga institucionet akademike, brenda ose jashtë vendit.

Aktivitetet e mësipërme mund të ofrohen si për tema

specifike të lidhura me specialitetin ashtu dhe për tema të përgjithshme mjekësore

Në mënyrë që profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit të përfitojnë kredite nga aktivitetet e lartpërmendura, këto të fundit duhet të jenë të akredituara paraprakisht nga institucione akredituese.

Numri i krediteve për pjesëmarrësit në këto aktivitete përlllogaritet në bazë të kriterit 1 orë – 1 kredit. Profesionistët të cilët marrin pjesë në këto aktivitete si lektorë ose trajnerë përfitojnë kredite që përlllogariten në bazë të kriterit 1 orë – 1.5 kredite

Grupi i aktiviteteve të edukimit të vazhduar për profesionistët e shëndetësisë të pa akredituara paraprakisht përfshin:

a) aktivitetet individuale, kreditet e të cilave përlllogariten nga institucioni akreditues (*kërkime/botime*) dhe b) aktivitete individuale, kreditet e të cilave përlllogariten nga vetë profesionisti që i ka kryer ato (*aktivitete të vetëraportuara*).

Kërkimet/botimet nënkuptojnë përfshirjen e profesionistit në punë kërkimore, që rezulton me shkrimin e artikujve profesionalë, librave, si dhe zhvillimin e kurrikulave shkollore. Këto aktivitete përfitojnë kredite, për të cilat

profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit mund të aplikojnë pranë institucionit akreditues. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Lloji i aktivitetit	Numri i krediteve
Botim artikulli në revistë shkencore	deri në 20
Botim kapitull në libër	deri në 20
Botim libri	deri në 50

Aktivitetet e vetëraportuara përfshijnë çdo formë të studimit individual si: studimin e materialeve, artikujve të shkruar, pjesëmarrjen në punë kërkimore, përdorimin e videokasetave që përmbajnë tema të lidhura me fushën specifike të profesionistit, ose vizitat studimore në institucione ose vende të tjera.

Aktivitetet e kësaj kategorie nuk mund të dokumentohen, ndaj dhe përfitimi i krediteve prej tyre bëhet në bazë të vetëraportimit të profesionistit, sipas procedurave të parashikuara në dokumentin e ricertifikimit. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Lloji i aktivitetit	Numri i krediteve
Lexim artikulli në revistë shkencore	0.5
Lexim libri shkencor	3

Numri i nevojshëm i krediteve të edukimit në vazhdim që një profesionist i përfshirë në programin e ricertifikimit duhet të mbledhë është si më poshtë:

- Kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim me temë të lidhur drejtpërdrejt me specialitetin e profesionistit duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti për secilin vit kalendarik ose/dhe për secilin cikël të programit të ricertifikimit.
- Kreditet e përfituara nga aktivitetet e vetëraportuara mund të përlogariten deri në 20% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti për secilin vit kalendarik ose/dhe për secilin cikël të programit të ricertifikimit.

3. Planet e edukimit: Si të krijoni një të tillë?

Zhvillimi dhe realizimi i planit tuaj të veprimeve për edukimin e vazhduar dhe zhvillim profesional kalon nëpër disa shkallë. Kjo paraqitje do t'ju ndihmojë të dokumentoni periodikisht planin tuaj. Procesi i hartimit të këtij plani i përgjigjet linjës së mëposhtme llogjike:

- Identifikoni nevojat e tuaja për njohuri në fushat e praktikës suaj mjekësore
- Prioritizoni nevojat tuaja
- Kërkoni për burime informacioni rreth këtyre fushave
- Vlerësoni rezultatet e këtij kërkimi për përdorshmërinë e tyre
- Nëse është e nevojshme merrni informacion të mëtejshëm
- Bëni kalimin nga njohuritë e përfutuara në praktikë
- Vlerësoni efektet e asaj çfarë keni mësuar në praktikën e punës suaj

Dhe gjithë procesi do të ndjekë hapat e paraqitur si vijon:

- a) *Listimi i kërkesave dhe standardeve profesionale për ushtrimin e profesionit*
- b) *Plotësimi i formularit të vete-vlerësimit*
- c) *Analizë e faktorëve të ndryshëm në funksion të planifikimit të aktiviteteve të EV në të ardhmen*
- d) *Hartimi i planit të EV për profesionistët e shëndetësisë*

Të shtjelluara këto hapa paraqiten si në vijim:

3.1 Listimi i kërkesave dhe standardeve profesionale për ushtrimin e profesionit,

Me këtë listim do të paraqiten standardet profesionale, standardet normative, udhërrëfyesit klinikë, protokolleve klinikë të diagnostikimit dhe trajtimit të gjendjeve shëndetësore. Këto dokumenta janë të formuluar nga institucione përgjegjëse për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre dhe kanë si objektiv rregullimin e ushtrimit të profesionit në fushën e kujdesit shëndetësor, përmbushjen e standardeve bashkëkohore profesionale në ushtrimin e profesionit, rregullimin e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet ofruesve të shërbimit dhe financuesve të tyre.

P.sh Udhërrëfyesit klinikë si: Udhërrëfyesit klinik për diabetin, hipertensionin, aksidentet cerebro-vaskulare, etj

janë të përgatitur nga QKCSAISH dhe janë të aprovuar për tu zbatuar në praktikën e punës nga mjekët e familjes që punojnë në kujdesin parësor shëndetësor.

A. Listoni kërkesat dhe standardet që aplikohen për profesionin tuaj dhe që mendoni se i përshtaten rastit tuaj si më poshtë:

Në kolonën e parë të tabelës së mëposhtme janë rreshtuar kërkesat që shtrohen përpara profesionistëve të shëndetësisë nga dokumenta rregullatore dhe institucione apo urdhra dhe shoqata profesionale, si psh kërkesat që rrjedhin nga procesi i ricertifikimit të hartuar nga QKEV, udhërrëfyesit klinikë të hartuar nga QKCSAISH, Paketa Bazë e Shërbime të kujdesit shëndetësor parësorë e hartuar për qendrat shëndetësore të shërbimit shëndetësor parësor që është pjesë e kontratës së financimit të këtij shërbimi nga ISKSH, dhe kërkesat që derivojnë nga përkatësia në urdhrat profesional dhe shoqatat profesionale.

Në kolonën e dytë çdo profesionist në bazë të specifikave të specialitetit dhe të qendrës së tij të punës apo praktikës profesionale do të listojë me emër këto kërkesa që dalin para tij përkatësisht për çdo dokument rregullator dhe institucion përkatës.

Kërkesat

Kërkesat e ricertifikimi	
Qendra e kontrollit të cilësisë, standardeve, akreditimit të institucioneve shëndetësore	<input type="checkbox"/>
Standardet e kërkuara në kontratat e shërbimit me institucionet shëndetësore (Qendrat shëndetësore, spitalet, farmacitë)	<input type="checkbox"/>
Kërkesat e shërbimeve profesionale	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>

3.2 Plotësimi i formularit të vetë-vlerësimit

- B.** Kur të plotësoni tabelat e mëposhtme, mbani në konsideratë aktivitetet tuaja profesionale aktuale ashtu si dhe aktivitetet e EV për të krijuar Planin e Aktiviteteve të EV sipas temave të veçanta.

Kolona I

Vlerësoni përqindjen e kohës suaj së shpenzuar në interpretimin e rasteve klinike ose në kryerjen e procedurave për çdo fushë specifike.

Kolona II

Tregoni se si mund të ndryshojnë prioritetet në praktikën tuaj mjekësore në secilën prej aspekteve të saj në dy ose tre vitet e ardhshme. (më prioritare, njësoj, ose më pak prioritare për secilën prej fushave të praktikës mjekësore).

Kolona III

Përgatisni një listë të aktiviteteve trajnuese në të cilat ju keni marrë pjesë më parë. Duke u bazuar në këtë liste shënoni numrin e aktiviteteve trajnuese (në të ardhmen numrin e krediteve) ku ju keni marrë pjesë për secilën prej fushave të praktikës suaj mjekësore. Shënim: Shumë aktivitete do të regjistrohen në më shumë se një fushë (p.sh, për radiologët që kanë marr pjesë në një trajnim për CT e krahërorit, ju duhet të shënoni si CT dhe krahërorin).

Kolona IV Rishikoni shënimet që keni bërë në kolonat I-III dhe më pas specifikoni se si do të doni ta strukturori pjesëmarrjen tuaj në aktivitete të EV në 2-3 vitet e ardhshme sipas fushave të ndryshme të praktikës suaj mjekësore.

Kolona V Krahasoni shpërndarjen e aktiviteteve edukuese si më sipër me përqindjen e kohës që ju shpenzoni në interpretimin teorik apo në kryerjen e procedurave praktike për secilën prej fushave të praktikës mjekësore. Kush ishte llogjika në përzgjedhjen e këtyre aktiviteteve të edukimit në vazhdim?

Shënim:

Për ta bërë më të kuptueshme paraqitjen në tabelën e mëposhtme po marrim një shembull ku specialiteti i mjekut është Radiolog:

Fusha	I Aktivitete Aktualisht % kohës	II Ndryshime në të ardhmen ↑ ↓(zgjidh:më shumë, më pak, njësoj)	III Historiku i trajtimeve (kreditet)	IV Plani juaj EV EV në të ardhmen	V Vetë- vlerësim/ Racionale/ Komente
Gjoksi		zgjidh..			
Zemra		zgjidh..			
Kraharori		zgjidh..			
CT		zgjidh..			
Edukim		zgjidh..			
Urgjenca		zgjidh..			
Gastrointestinale		zgjidh..			
Të përgjithshme		zgjidh..			
Gjenito-urinare		zgjidh..			
Koka & Qafa		zgjidh..			
Politikat Shëndetësore		zgjidh..			
Informatika		zgjidh..			
Menaxhimi		zgjidh..			
Imazheria molekulare		zgjidh..			
Muskulo-skeletale		zgjidh..			
Mamografia		zgjidh..			
MRI		zgjidh..			
Mjekësia Nukleare		zgjidh..			
Neuroradiologjia		zgjidh..			

Fusha	I Aktivitete Aktualisht % kohës	II Ndryshime në të ardhmen ↑ ↓(zgjidh:më shumë, më pak, njësoj)	III Historiku i trajtimeve (kreditet)	IV Plani juaj EV EV në të ardhmen	V Vetë- vlerësim/ Racionale/ Komente
Ob / Gjijn		zgjidh..			
Imazheria - Onkologjike		zgjidh..			
Pediatria		zgjidh..			
CT		zgjidh..			
Fizika / Shkenca Baze		zgjidh..			
Rrezatimi Onkologjik		zgjidh..			
Ultratinguj		zgjidh..			
Nderhyrje / Vaskulare		zgjidh..			
Te tjera		zgjidh..			

Plotësoni ju lutem kolonat I, II, dhe III me konsideratat tuaja nga tema që lidhen me praktikën tuaj profesionale.

Fusha	I Historiku i trajnimeve (kreditet)	II Plani juaj EV EV në të ardhmen	III Vetë-vlerësimi Racionale/ Komente
Komunikimi			
Mjekësia-bazuar në evidenca			
Profesionalizmi (përfshi dhe etikën)			
Sigurimi i cilësisë/ Përmirësimi			
Siguria e pacientit			
Kërkimi Shkencor/ Statistikë			

C. Për të zhvilluar më tej Planin e Aktiviteteve të EV, vlerësoni proporcionin e kohës tuaj të shpenzuar në aktivitetet e mëposhtme:

Aktiviteti	%
Kujdesi Klinik	
Mësimdhënie	
Kërkim Shkencor	
Administrim/Menaxhim	
Informatikë	
Konsulta	
Shërbime Vullnetare	
Të tjera	

3.3 Analizë e faktorëve të ndryshëm në funksion të planifikimit të aktiviteteve të EV në të ardhmen

D. Reflektoni mbi pyetjet e mëposhtme:

- Si mund të krahasohet shpërndarja e aktiviteteve të edukimit në vazhdim me atë të aktiviteteve profesionale aktuale dhe të atyre që parashikohen në të ardhmen? Shënoni çdo ndryshim domethënës.

- Si mund të krahasohet shpërndarja e aktiviteteve të edukimit në vazhdim me atë të kërkesave që ju identifikuat në pikën A të këtij dokumenti? Shënoni çdo ndryshim domethënës.

- Çfare boshllëqesh në aftësitë apo njohuritë tuaja ju keni identifikuar me anë të vetë-vlerësimit formal apo reflektimit individual, vitin e shkuar?

- Çfare metodash të reja apo trajnimesh nevojiten për të përditësuar performancën tuaj në fushat më kryesore të praktikës suaj mjekësore?

- Çfare trajnimesh apo materialesh didaktike ju duhenpërtëmbajturnëniveline duhur kompetencat tuaja si profesionist në fusha përtej atyre që janë më kryesore në praktikën tuaj mjekësore ?

- A reflekton shpërndarja e aktiviteteve tuaja edukative kërkesat e programit të ricertifikimit?

E. Në vijim, si mendoni të parashikoni natyrën e ndryshimit të praktikës suaj profesionale në dy-tre vitet e ardhshme? Shënojin ato këtu.

Praktikat e diagnostikimit dhe trajtimit: _____

(psh praktikat e diagnostikimi dhe trajtimit të gripeve sezonale për mjekët e përgjithshëm/familjes)

Protokollet klinike: _____

(psh. Udhërrëfyesit për kujdesin shëndetësor parësor)

Shpërndarja e kohës: _____

(Koha që harxhohet për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme)

Demografia e pacientëve: _____

(psh. Ndryshimi i numrit të gjendjeve shëndetësore që paraqiten përpara MPF bazuar në lëvizjen e popullatës në zonen që ai mbulon dhe në tendencën e perceptuar prej tij në gravitetin dhe shpeshtësinë e një apo disa gjendjeve shëndetësore)

Procedurat e kryera: _____

(p.sh procedurat e kryera në rastin e një urgjence mjekësore në kujdesin parësor)

Ndryshime të tjera: _____

- F.** Ndaloni për një moment dhe rishikoni përgjigjet tuaja për pikat nga C në F. Kur ti merrni në konsideratë ato ashtu si dhe çdo ndryshim që ju do të donit të realizonit bazuar në qëllimet tuaja personale, analizoni se çfarë nevojash kryesore për edukim ju identifikoni për veten tuaj? (p.sh në rastin e radiologëve, PET/CT të kraharrorit)?

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

G. Përpara se të kompletioni planin e aktiviteteve të EV, identifikoni se në çfarë forme e doni ta merrni informacionin e ri duke shënjuar tre nga mënyrat e mëposhtme të EV:

■ Ndjekja e leksioneve, ■ Trajnim praktik

■ Lexim materiale trajnuese ■ Uorkshope

■ Konsulta me koleget ■ Video

■ Edukim në distancë ■ Konferenca

■ Lexim revistash shkencore ■ Të tjera:

I. Kompletoni tabelën në faqen tjetër, duke përdorur informacionin nga të gjithë seksionet e mëparshme. Listoni synimet prioritare të të mësuarit dhe burimet e mundshme të informacionit për to.

Rishikoni here pas here planin tuaj të aktiviteteve të EV dhe shënoni progresin e arritur, shënoni si keni aplikuar ato që keni mësuar, dhe cfare domethënie ka kjo për synimet tuaja të edukimit në vazhdim për të ardhmen. Këto shënime do t'ju ndihmojnë të përditësoni planin e aktiviteteve për vitin tjetër.

3.4 Hartimi i planit të EV për profesionistët e shëndetësisë

Kolona e I

Në kolonën e parë të tabelës së mëposhtme vendosni nevojat për edukim profesional të identifikuar nga ju.

Kolona e II

Në kolonën e dytë vendosni nivelin e prioritetit që ka për ju edukimi profesional për sa i takon këtyre nevojave specifike në raport me rëndësinë e aplikimit të njohurive dhe kompetencave të reja në praktikën mjekësore.

Kolona e III

Në kolonën e tretë vendosni aktivitetet e EV të identifikuara nga ju që përmbushin këto nevoja për edukim profesional.

Kolona e IV

Dhe së fundmi në kolonën e katërt vendosni eksperiencën e fituar nga aktiviteti i edukimit profesional që keni realizuar dhe ndryshimet në praktikën tuaj klinike si rezultat i aplikimit të njohurive dhe kompetencave të reja.

Shënim:

Për ta bërë më praktik planin po paraqitet rasti i planifikimit për një mjek radiolog.

Nevoja për trajnim të identifikuar	Niveli i prioritetit (1 – 5)	Aktivitete të edukimit të vazhduar	Eksperienca e fituar, ndryshimet në praktikën klinike, hapat e tjerë

4. Të mësuarit gjatë gjithë jetës. Si mund ta bëni atë pjesë tuajën?

Përmbushja me sukses e kërkesave të programit të ricertifikimit nënkupton që profesionistët e sistemit shëndetësor brenda një periudhe 5 vjeçare të plotësojnë një numër kreditesh që në ciklin e pare të ricertifikimit do të jetë 150 kredite, dhe në ciklet e tjera pasuese do të jenë 250 kredite.

Të gjesh kohë për edukimin në vazhdim në një jetë të mbushur me aktivitete pune dhe gjithashtu me veprimtari të jetës private, është diçka që kërkon një qasje të organizuar dhe praktike për të siguruar që ju vazhdoni të përmirësoni njohuritë tuaja në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur.

Mënyra më e mirë për ta vendosur këtë proces të mësuarit në vazhdim në funksionin tuaj, është të siguroheni që edukimi profesional që ju kryeni ti përgjigjet nevojave tuaja në mënyrat që paraqiten më poshtë:

- Është domethënës për jetën tuaj;
- I përgjigjet pyetjeve që dalin në praktikën tuaj;
- Plotëson “boshllëqe” në njohuritë tuaja ose në aftësitë tuaja.

Veprimtaritë e edukimit në vazhdim duhen konsideruar jo si një barrë tjetër e shtuar në listën tuaj të punëve dhe angazhimeve, por ato si një mjet për të adresuar nevojat dhe problemet që ju keni tashmë në listën tuaj.

4.1 Vlerësoni nevojat tuaja për EV

Hapi i parë në organizimin e aktiviteteve tuaja të të mësuarit është të vlerësoni nevojat tuaja për EV. Hidhni një vështrim analizues praktikës suaj profesionale dhe mundohuni të përcaktoni se cilat nga njohuritë dhe aftësitë tuaja keni nevojë të përmirësoni, ose ti zgjeroni në funksion të përmirësimit të kujdesit shëndetësor që ofroni.

Plotësimi dhe paraqitja pranë QKEV-së i formularit të vetë-vlerësimit nga profesionistët e shëndetësisë që janë subjekt i programit të ricertifikimit do të vlerësohet nga QKEV-ja vlerësohet me dy kredite.

Plani i aktiviteteve të EV është një mjet planifikimi që do të paraqitet dhe në faqen në internet të QKEV-së dhe që ka si synim t'ju ndihmojë për të kryer një vlerësim të nevojave tuaja për EV. Ky plan aktivitësh ju orienton ju përgjatë një procesi në të cilin ju do të listoni kërkesat tuaja për EV, do të bëni prioritizimin e nevojave tuaja për

edukim, do të planifikoni aktivitetet e ardhshme të EVM dhe do të ruani këto aktivitete edukuese për qëllimet e procesit të të mësuarit përgjatë gjithë jetës.

Seksioni i vetë-vlerësimit në Planin e Aktiviteteve të EV ka një pyetësor që kërkon nga ju të bëni një vlerësim të përqindjes së kohës që ju shpenzoni në interpretimin e rasteve klinike apo në kryerjen e procedurave në fusha specifike të praktikës suaj profesionale dhe të tregoni nëse praktika juaj në të ardhmen, si pasoje e këtij procesi edukimi, do të ketë intesitet më të lartë pune, më të ulët apo të njëjtin.

Ju, ju kërkohet gjithashtu të vlerësoni përqindjen e kohës që ju i kushtoni aktiviteteve të tjera si mësimdhënia, kërkimi shkencor, administrimi dhe konsultat. Dhe në vijim ju krahasoni atë që jeni duke bërë me llojin e edukimit në vazhdim që ju jeni duke marrë.

I orientuar nga pyetje si këto dhe të tjera, ju do të jeni në gjendje të krijoni profilin tuaj të nevojave për edukim dhe të planifikoni aktivitetet e edukimit në vazhdim për vitin në vazhdim.

4.2 Bëhuni proaktiv

Mbasi të keni vlerësuar nevojat tuaja, hapi tjetër është të jeni proaktiv në marrjen e krediteve të EV. Ju duhet të

kërkoni për mundësi edukimi që plotësojnë nevojat tuaja për të mësuar.

Faqja në internet e QKEV-së është një mundësi e mirë për profesionistët e sektorit të shëndetësisë për të gjetur dhe përdorur formularin e vet- vlerësimit si dhe të një informacioni mbi kurset e ndryshme trajnuese që ofrohen nga shoqatat profesionale dhe ofrues të tjerë të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, si dhe një informacion më të plote për aktivitetet e edukimit në vazhdim të financuara nga MSH me ndihmën teknike të QKEV-së për ato kategori profesionistësh dhe fushash trajnimi të vlerësuara prioritare nga këto insitucione.

4.3 Koordinoni aktivitetet tuaja

Mbasi të keni plotësuar formularin e vetë-vlerësimit, hapi final është të koordinoni aktivitetet tuaja duke ruajtur kreditet që keni marrë dhe planifikuar aktivitetet e edukimit në të ardhmen.

Në vijim të ndihmës për vlerësimin e nevojave tuaja për trajnim, plani i aktiviteteve për EV do t'ju ndihmojë të krahasoni aktivitetet tuaja të EV në të shkuarën me aktivitetet aktuale dhe të planifikuara për të ardhmen dhe të identifikoni boshllëqe të mundshme në aftesitë ose njohuritë tuaja me synim vijushmërinë e procesit të planifikimit të aktiviteteve për të ardhmen.

5. Përmirësim i cilësisë së praktikës mjekësore

Përpara se të përmirësoni punën tuaj, ju duhet të dini se si po punoni. Për këtë arsye, QKEV-ja i sugjeron profesionistëve të shëndetësive të përfshirë në procesin e ricetifikimit të kryejnë të paktën një proces të *përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë* përgjate një periudhe 5 vjecare të procesit të ricetifikimit. Secili nga këto proçese duhet të përkojë me një nga 5 kategoritë që do të paraqiten më poshtë. Ju mund të zgjidhni të punoni me një nga këto kategori në mënyra të ndryshme.

- *Përputhshmëria me udhëzuesit klinik dhe standartet teknike.* Në këtë kategori, ju duhet të vlerësoni nëse praktika e punës suaj përputhet dhe sa përputhet me udhëzuesit klinik dhe standartet teknike nëse ekzistojnë) të zhvilluara nga shoqatat profesionale apo nga departamentet e Fakultetit të Mjekësisë duke përdorur metoda të bazuara në fakte dhe duke përfshirë konsensusin e ekspertëve.
- *Saktësia e interpretimit tuaj profesional për një rast të paraqitur në praktikën tuaj mjekësore.* Ju mund të vlerësoni se sa me saktësi ju interpretoni analizat laboratorike dhe ato imazherike me një proces interpretimi dyfish ku dy profesionistë

interpretojnë të njëjtin rast të një gjendje shëndetësore të paraqitur në praktikën tuaj profesionale. Më tej ju duhet të mblidhni të dhëna se si specialistë të tjerë bien ose jo dakort me diagnozën tuaj. Këtë gjë ju mund ta arrini duke krijuar një rrjet tuajin të shkëmbimit të ekspertizës dhe informacionit me kolegët tuaj.

- *Referimi në kohë.* Ju mund të mblidhni të dhëna për kohën që ju duhet për interpretimin e rasteve të ndryshme klinike, ose në referimin e rastit. (në rastin e radiologëve nga moment i marrjes së imazhit në dhënien e recetës referuese për tek mjeku përkatës specialist)
- *Siguria e pacientit dhe ulja e numrit të gabimeve mjekësore.* Kjo kategori është e ngjashme me të parën, por këtu ju do të vlerësoni se sa mirë praktika juaj e punës garanton sigurinë e pacientit, si dhe sa i përshtatet udhëzuesve të sigurisë së pacientit (nëse ekzistojnë) të hartuar nga departamentet e Fakultetit të Mjekësisë, nga shoqatat e profesionisteve, urdhri i mjekut ose nga organizma të tjerë që promovojnë shëndetësinë e bazuar në evidenca, matjen e performancës klinike dhe përmirësimin e sigurisë së pacientëve (QSCSA-ISH).

Vëzhgim i referime të kryera. Këto vëzhgime synojnë të përcaktojnë se sa të kënaqur janë mjekët ku ju referoni pacientet tuaj me shërbimin e ofruar nga ju.

Në përgjithësi projektet e përmirësimit të cilësisë së praktikës profesionale janë në formatin që paraqitet si vijon:

- Zgjidhni një temë apo fushë të profesionit dhe vendosni se çfarë do të masni me qëllim që të vlerësoni performancë tuaj aktuale dhe përmirësimet në të ardhmen. Një formë për mbledhjen e të dhënave rekomandohet për të ruajtur të dhënat e dala nga kjo matje.
- Kryeni një numër të caktuar matjesh për një numër të mjaftueshëm rastesh
- Analizoni rezultatet e matjeve
- Identifikoni shkaqet potenciale të gabimimeve apo të performancave jo-optimale
- Implementoni planin e përmirësimit

Masni përsëri: Përcaktoni nëse keni arritur ose jo qëllimet që kishit vendosur për performancën tuaj; nëse nuk keni arritur synimin tuaj, zgjidhni dhe filloni një projekt tjetër, ndërkohë që ruani arritjet e projektit fillestar; nëse po, vazhdoni me projektin fillestar

Referenca:

- a. *Dokumenti Rregullator për Ricertifikimin e Profesionistëve të Shëndetësisë;*
- b. *Formularët e vetë-vlerësimit të planifikimit individual të aktivitetëve të edukimit të vazhduar mjekësor nga Shoqata e Radiologjisë e Amerikës së Veriut, www.rsna.org/*
- c. *Udhëzuesit klinike dhe protokollet e diagnostikimit dhe trajtimit të gjendjeve shëndetësore të përgatitur nga QKSCA-ISH*
- d. *Kontrata e Paketës Bazë të Shërbimeve midis qendrave shëndetësore të shërbimit të kujdesit parësor në Shqipëri dhe ISKSH,*
- e. *Toolkit for CME planning, www.whcenter.org/*
- f. *Dokumenti Rregullator për Akreditimin e Aktivitetëve të Edukimit të Vazhduar për profesionistët e shëndetësisë.*

**DOKUMENTI
I PLANIFIKIMIT INDIVIDUAL
TE AKTIVITETEVE
TE EDUKIMIT TE VAZHDUAR
PER PROFESIONISTET
E SHENDETESISE**